

VENDIM
Nr.317, datë 13.5.2005

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT
VENDAS ME ATË TË BASHKIMIT EUROPIAN DHE ZBATIMIT TË ANGAZHIMEVE, QË
RRJEDHIN NGA MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integritetit Europian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Plani Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, plotëson dhe përmirëson angazhimet e marra në Planin e Veprimit për Zbatimin e Përparësive të Partneritetit Europian.

3. Ministri i Integritetit Europian të ndjekë zbatimin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore dhe të raportojë në Këshillin e Ministrave.

4. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave, të informojnë pranë Ministrit të Integritetit Europian, në fillim të çdo tremujori, për realizimin e detyrave, që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, dhe për realizimin e detyrave të parashikuara në vendimin nr.634, datë 30.8.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Përparësive të Partneritetit Europian”.

5. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e tjera qendrore që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqesin propozimet, përkatësisht në:

a) Ministrinë e Financave dhe Departamentin e Administratës Publike, për shtesa dhe ndryshime në burimet njerëzore, në mbështetje të objektivave të parashikuara në këtë plan kombëtar, të cilat të jenë objekt shqyrtimi e miratimi nga këto institucione, përpara miratimit përfundimtar sipas ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, për strukturat e organikat e institucioneve shtetërore.

b) Ministrinë e Financave, për nevojat financiare për zbatimin e masave afatshkurtra, të parashikuara në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit.

6. Ngarkohet Ministri i Integritetit Europian, që brenda 6-muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të propozojë në Këshillin e Ministrave projektvendimin për miratimin e instrumenteve të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian.

7. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet, për të cilat në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, janë përcaktuar detyra specifike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano